



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.
Nr. Doculive 201700567/5

Prot.

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë dhënien e plotë të masës së pensionit të pleqërisë të të moshuarit E.K dhe kthimin e shumës së mbajtur.*

Drejtuar: **Zj. Daniela HASIMAJ**
Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve

FIER

Siç jeni në dijeni, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i moshuari *E.K*, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosdhënien e plotë të masës së pensionit të pleqërisë që i takon.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi që prej 8 vjetësh është sistemuar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier. Masa e pensionit në total është 15164 lekë në muaj. E ka marrë rregullisht 40% nga kjo masë deri në fund të vitit 2016.

Pretendimi i tij qëndron në faktin se që nga muaji Janar 2017 nuk e ka marrë të plotë masën e pensionit të pleqërisë, duke iu mbajtur më shumë se 40 %. Pavarësisht interesimit të vazhdueshëm si pranë jush, ashtu edhe në Bashkinë Fier, nuk ka mundur të zgjidhë këtë çështje.

Për nevojat e shqyrtimit të kësaj ankese, ju jemi drejtuar për të na dhënë shpjegimet e duhura për trajtimin e këtij rasti.

Në përgjigje të kërkesës sonë, ndër të tjera na keni informuar se:

"...Të moshuarit të cilët përfitojnë shërbime nga institucionet rezidenciale nuk përfitojnë kompensime për energjinë elektrike dhe për bukën. Kështu, nga masa totale e pensionit i zbritet kompensimi i energjisë elektrike dhe bukës, që i moshuari E.K e ka 500 lekë në muaj..."

Në analizë të akteve ligjore, të cilat ju i referoheni, konstatojmë se:

-VKM nr.138 datë 31.03.1994 "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të për energjinë elektrike dhe lëndëve djegëse", i ndryshuar, ka përcaktuar kategoritë përfituese që u jepet kompensimi mujor..

Në asnjë dispozitë të këtij vendimi nuk përcaktohet kompetenca e Institucioneve të Përkujdesjes Shoqërore për zbatimin e tij në rastet kur në këto institucione strehohen të moshuar që janë përfitues të pensionit të pleqërisë.

Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore janë institucionet shtetërore kompetente për dhënien ose jo të këtij përfitimi.

VKM nr.114 datë 31.01.2007 "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në Institucionet Rezidenciale Publike të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror", i ndryshuar, .ka përcaktuar grupet, pagesat dhe përfitimet e personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, ku sipas 2 :

"2. Personat, që kanë të ardhura, si pension pleqërie, shtetërorë, kooperative apo pension familjar a invaliditeti, kur vendosen dhe përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale publike, derdhin 40 për qind të pensionit".

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Dhënien e plotë të masës së pensionit të pleqërisë të të moshuarit E.K dhe kthimin e shumës së mbajtuar.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit", lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI